



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVETKOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KOMISIONI DISIPLINOR//DISCIPLINSKA KOMISIJA/ THE DISCIPLINARY COMMITTEE

KD.nr.5/2017

KOMISIONI DISIPLINOR, në përbërje nga gjyqtarët, Nenad Lazic, kryetar, Manushe Karaqi dhe Skender Çoçaj, anëtarë të Komisionit, në procedurën disiplinore ndaj Xxx xxxxt, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Xxxxxx, sipas raportit përfundimtar të Zyrës së Prokurorit Disiplinor me numër ZPD-2016-292/A, në procedurën e Komisionit Disiplinor ka marr numrin KGJK/KD/13/2017, për sjellje të pahijshme sipas nenit 34 paragrafi 1 pika 1.3 dhe 1.4 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, në seancën e mbajtur në prezencën e përfaqësuesit të ZPD-së, z. Kadri Begolli, dhe Xxx xxxx, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Xxxxxx, më datën 07.03.2017, në bazë të nenit 37 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, merr këtë:

V E N D I M

1. **Xxxx xxxx**, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Xxxxxx, **është** përgjegjës për sjellje të pahijshme sipas raportit përfundimtar të Zyrës së Prokurorit Disiplinor me numër ZPD-2016-292/A, i cili në procedurën te Komisioni Disiplinor ka marr numrin KGJK/KD/13/2016, sipas nenit 34 paragrafi 1 pika 1.3 dhe 1.4 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës.
2. Për sjellje të pahijshme të konstatuar, gjyqtarit Xxx xxxx, i shqiptohet masa disiplinore - **QORTIM**.

A r s y e t i m

Raportin përfundimtar ZPD-2016-292/A se bashku me shkresat e lëndës, Zyra e Prokurorit Disiplinor ja ka paraqitur Komisionit Disiplinor të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, më të cilin e ka ngarkuar Xxx xxxxn, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Xxxxxx për sjellje të pahijshme të përcaktuar sipas nenit 34/paragrafi 1 pika 1.3 dhe 1.4 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

Hetimin disiplinor ZPD e kishte filluar në bazë të parashtrës së xxxxx xxxxx nga xxxxx, Rr, “Vellëzrit Fazliu” 206. Me anë të kësaj parashtrës, z.xxxx xxxxx nga xxxxx ka theksuar se në Gjykatën Themelore në Xxxxxx, me datë 23 janar 2014 ka parashtruar padinë për pengim posedimi kundër xxxx (Raif) xxxxxi. Kjo padi deri me tani nuk ishte marrë në punë. Në vazhdimësi parashtruesi thekson se xxxx (Raif) xxxxxx, si palë e paditur në rastin e tij, me datë 23

mars 2016 ka paraqitur në Gjykatë padinë për pengim posedimi tani kundër parashtruesit Xxxx (Faik) Xxxxx. Kjo padi është marr në punë nga Gjykata edhe pse e njëjta është parashtruar aton nga viti 2016 ndërkaq padia e parashtruesit, e cila daton nga viti 2014, nuk është marr në punë edhe pse objekti i kontestit është i njëjtë pengim posedimi.

Në seancën dëgjimore të Komisionit Disiplinor të mbajtur me datë 07.03.2017, përfaqësuesi i ZPD-së ka deklaruar së rekomandimin lidhur më këtë rast e ka mbështetur me provat materiale që janë në shkresat e lëndës civile, në raportet e nxjerra nga Gjykata sa i përket kryerjes së lëndëve nga gjyqtari dhe se një provë shumë e rëndësishme është deklarimi i vetë gjyqtarit që e ka bërë në bazë të kërkesës së ZPD-së. Çështja e civile e pengim posedimit është vonuar në procedim për muaj të tërë, konkretisht 34 muaj dhe se dyti fakti se mos veprimi i gjyqtarit Xxxxxxx në këtë lëndë është bërë nisur nga pritja të cilin gjyqtari e ka bërë që pala paditëse ta tërheq padinë dhe atë bazuar në njohurit personale që gjyqtari kishte pasur me palën paditëse dhe familjaret e tij. E gjithë kjo ka ndikuar që te krijohet një perceptim i gabuar të pala tjetër e cila ka qenë paditëse në të njëjtin kontest, se gjykata i trajton palët në mënyrë jo të barabartë.

Gjyqtari Xxxx xxxx në seancë ka deklaruar se i gjithë raporti i ZPD-së ka të bëjë me lëndën 225/2014, të cilën e kishte pranuar me 23 janar 2014 dhe se në këtë lëndë paditës ka qenë Xxx Xxxxx kurse i paditur Xxxx xxxx, djem të axhës ndërmjet veti dhe vijnë nga i njëjti fshat nga vij edhe unë. Nuk i kam as në farë as fis përveç që edhe ai me ka njohur dhe unë e kam njohur mirë. Ka theksuar se e ka takuar rastësisht paditësin Xxxx Xxxxxx i cili i kishte treguar se ka bërë një padi kundër xxxx xxxxxx (djalit te axhës se tij) sepse kanë problem lidhur me 2-3 ari tokë. Gjyqtari nuk i kishte treguar se e kishte lëndën ai por vetëm ja kishte bërë me dije se si familje e mirë dhe e njohur dhe me tokë mbi 80 hektar, me ju dëgjuar dikush, është marre. Paditësi Hamdi Xxxxx i kishte premtuar që do të bisedoj me vëllezërit e tjerë dhe do ta tërheq padinë. Ka deklaruar që lëndën e kishte lëndë të vitit 2014 dhe pasi që ka pasur një numër të madh të lëndëve, 1040 lëndë nuk i ka ra shpesh që ti kap nëpër duar. Në 2016 e kishte ngritur padinë djali i mixhës dhe kjo lëndë ju kishte ndarë gjyqtarëve të rinjë që kishin ardhur në gjykatë. Kur është marrë vesh që edhe pala tjetër e ka një padi, për të njëjtën çështje kanë bërë kërkesë për bashkimin e lëndëve dhe që të shkoj të gjyqtari Xxxxxxx. Sipas gjyqtari, ai kishte ndërmarr një veprim dhe ja kishte dërguar padinë palës së paditur, por ju kishte kthyer për shkak të adresës së panjohur, mandej ja kam dërguar paditësit për plotësim. Thekson se nuk qëndron pretendimi që lënda ka qenë të unë për 34 muaj, por 27 muaj, edhe pse edhe këta muaj janë shumë. Neni 479 i ligjit shkruan kështu, citoj “me rastin e konvertimit të afateve dhe caktimit të seancave gjithmonë i kushtohet kujdes nevojës së ngutshme të zgjidhjes së kontesteve për shkak të pengim posedimit dhe se duke marrë parasysh natyrën e secilit rast konkret. Nuk pajtohet me pretendimin e ZPD-së se kam kryer sjellje të pahijshme, se kam shkelur kodin e etikës sepse kurrkund në kodë shprehimisht shkruhet se kur e nje palën, gjyqtari duhet të kërkoj vetë përjashtim.

Përfaqësuesi i ZPD-së ka theksuar se edhe gjyqtari e edhe ne nuk mundemi me jetuar në një vend ku nuk na nje askush, dhe se është normale që gjyqtari i Xxxxxxx i nje palët, por gjyqtari

ka pasur obligim ashtu siç e përcakton ligji të vetë përjashtohet, për çdo situatë kur e sheh që vendimi i tij mundë të perceptohet prej një palë si i një anshëm dhe e dyta komisioni duhet të këtë parasysh që gjyqtari në vitin 2014 i ka pasur 8 lëndë të pengim posedimit dhe të gjitha i ka kryer, në 2015 i ka pasur 4 lëndë të kontestit pengim posedimi dhe të gjitha i ka kryer i ka mbetur vetëm kjo lëndë e pa kryer dhe se e gjithë kjo ka krijuar bindjen të parashtruesi i ankesës, që palët po trajtohen në mënyrë jo të barabartë.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i ZPD-së ka deklaruar se nga provat që i kemi administruar mendon se është vërtetuar që gjyqtari ka kryer sjellje të pahijshme ashtu siç është përcaktuar në përkrahje dhe me kualifikim juridik, dhe ka kërkuar nga Komisioni që ta aprovoj raportin dhe gjyqtarit ti shqiptoj sanksion disiplinor konform gjetjeve të këtij raporti përfundimtar.

Gjyqtari Xxxx xxxx në fjalën përfundimtare theksoj që qëndron prapa të gjitha atyre që i deklaroj gjatë seancës dëgjimore, konsideron se nuk ka bërë sjellje të pahijshme siç pretendon ZPD-ja. Nuk ka pasur për qëllim të mbaj anën e asnjërës palë, por qëllimi i mirë ka qenë që palët të mos hyjnë farë në këtë proces në gjykatë. Sa i përket pretendimit të ZPD-së pse nuk jam vetë përjashtuar nga kjo lëndë unë ju thamë se çdo here para seancës i pyes palët se a kanë vërejtje në përbërjen e trupit të gjykatës dhe ata jo vetëm që nuk kanë pasur vërejtje por janë kanë të kënaqur që lënda është të ai sepse është gjyqtar me përvojë në këto çështje.

Komisioni Disiplinor i administroj të gjitha provat në shkresat e lëndës, shqyrtoj parashtruesat e dorëzuara nga ZPD-ja që kanë qenë të bashkangjitura në raportin përfundimtar si dhe ka dëgjuar edhe deklaratën e gjyqtarit të dhënë në seancë.

Komisioni pasi i ka vlerësuar të gjitha provat, konstatoj se gjyqtari Xxxxxx, ka dështuar që ta procedoj rastin e parë C.nr.225/14, me objekt kontesti pengim posedimi sipas ligjit ndonëse e kishte pranuar me datë 11 shkurt 2014, duke pritur tërheqjen e munguar të padis nga vetë paditësi Xxxx Xxxx, pritje kjo e bazuar nga njohja personale ngase edhe kishin biseduar lidhur me çështje personalisht paditësi xxxx xxxxx dhe gjyqtari Xxxxxxx. Sipas Komisioni gjyqtari Xxxxxxx po ashtu është dashur që të vetë përjashtohet nga kjo lëndë, për shkak se të dytë e kanë njohur njeri tjetrin, kanë qenë bashkëfshatar, përkundër që palët nuk kanë kërkuar përjashtimin, në mënyrë që mos të krijohet perceptim për anshmëri tek pala tjetër.

Në seancën për shqyrtim dhe votim, Komisioni njëzëri vendosi që Xxxx xxxx është përgjegjëse për sjellje të pahijshme të një gjyqtari sipas nenit 34 paragrafi 1 pika 1.3 dhe 1.4 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe shkelje të Kodit të Etikës për Sjellje Profesionale për Gjyqtar.

Për këtë sjellje të pahijshme të vërtetuar të gjyqtarit Xxxx xxxx, Komisioni vendosi njëzëri masën disiplinore të **Qortimit**, duke menduar se masa e caktuar disiplinore ajo është në përputhje me peshën shkeljes disiplinore të shkaktuar dhe nivelin e përgjegjësisë së gjyqtarit.

Në bazë të nenit 37 paragrafi 1 nën pikën 1.1 dhe paragrafit 2 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës u vendos si ne disipozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR
KD.nr.5/2017, date 07.03.2017

Kryetar i Komisionit Disiplinor

Gjyqtari, Nenad Lazic

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese pranë Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në Xxxxxx, brenda 15- ditësh nga dita e pranimet të Vendimit.

Vendimi u dërgohet;

- Nehat Idrizi, kryesues i KGJK-ës;
- Zef Prendrecaj, drejtor, Zyra e Prokurorit Disiplinor;
- Xxxxxx xxxx, kryetare i Gjykatës Themelore në Xxxxxxx;
- Xxxx xxxx, gjyqtar në Gjykatën Themelorë në Xxxxxxx;
- Administratës se Personelit në Sekretariatit e SKGJK-së;